



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:264654

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05515182

CP.nr.448/12

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K...SH.A. me adresë në rrugën ..., me seli në Mitrovicë, kundër debitorit S.Sh nga Vushtrria rruga ... lidhur me pagesën e borxhit, jashtë seance me datë 27.03.2024, mori këtë:

K O N K L U Z I O N

I. PEZULLOHET procedura përmbartimore në çështjen CP.nr.448/12 për shkak të vdekjes së debitorit.

II. Procedura e pezulluar sipas pikës I të këtij konkluzioni mund të vazhdojë nëse kreditori në afat prej 6 muajsh gjykatës i propozon caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për debitorin S.Sh, në të kundërtën, procedura e pezulluar konsiderohet e përfunduar.

A r s y e t i m

Kreditori K...SH.A, me datë 22.11.2007, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit S.Sh nga Vushtrria rruga ..., në bazë të dokumentit të besueshëm, dhe atë faturës së datës 31.12.2006 dhe 31.10.2007, me të cilën është obliguar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 77.00 Euro, në emër të borxhit si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata me aktvendimin E.nr.937/07 të datës 23.11.2007, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit. Nga certifikata e vdekjes e datës 03.03.2005, me numër të certifikatës .. dhe numër rendor ..., gjykata ka konstatuar se debitori ka vdekur me datë *data e vdekjes*.

Meqenëse, nga dita e vdekjes e deri më sot nuk është propozuar përfaqësuesi i përkohshëm për debitorin S.Sh, dhe as nuk ka marrës përsipër të procedurës në këtë çështje, gjykata, konform nenit 35 par. 4 lidhur me nenin 65 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CP.nr.448/12, me datë 27.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij konkluzioni, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.